



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIKA OF
KOSOVA

AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA ZA BORBU PROTIV KORUPCIJE NA KOSOVU
KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY



KONKURS

Titulli i postit: Zyrtarë i Lartë për Zbulim dhe Hetime
Organizata: Agjensioni Kosovar Kundërkorrupsionit – Departamenti për Strategjinë Antikorrupsion dhe Hetime
Administrative

Shifra e postit: DSAHA-2.09
Koeficienti i postit: 7
Paga: 228 €
Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë

Zyrtari i Lartë për Zbulim dhe Hetime nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit dhe nën udhëheqjen e Shefit të Divizionit për Hetime, ushtron përgjegjësitë e mëposhtme:
Kryerjen e hetimeve administrative për rastet e korrupsionit publik dhe privat,
Mbledhjen e informacionit të nevojshëm për hetimet administrative të korrupsionit dhe përgatitjen e Propozim-Vendimit për fillimin e hetimeve administrative apo për mbylljen e rastit të caktuar dhe procedimin e tij te Drejtori i Departamentit për Hetime,
Përgatit Raportin për përfundimin e hetimit administrativ të korrupsionit si dhe rekomandimin për hapat e mëtuajtshëm dhe procedimin e tij te Drejtori i Departamentit për Hetime,
Përgatitjen e raporteve të ndryshme për punën e Departamentit për Hetime,
Kryen edhe punë të tjera me kërkesën e Drejtorit të Departamentit, Shefit të Divizionit si dhe të Drejtorit të Agjencionit.

Kualifikimet e nevojshme:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje universitare drejtimi i drejtësisë;
- Një (1) vite përvojë pune profesionale,
- Ai ose ajo duhet të ketë njohuri të mira në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe
- Ai ose ajo duhet të jetë në gjendje të punojë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti.
- Ai ose ajo duhet të jetë i gatshëm ose e gatshme të punojë jashtë orarit nëse është e nevojshme,
- Të jetë banor i përhershëm i Kosovës,
- Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm,
- Njohja e punës me kompjuter Word-i, Excell-i , interneti, përpunimi i tekstit dhe përgatitja e raporteve buxhetore e prezantimeve janë të domosdoshme,
- Kërket njohuri e shkëlqyer e gjuhës shqipe dhe /ose e gjuhës serbe, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi.

INFORMATAT E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Kohëzgjatja e kontratës për të gjitha postet është 3 vjet me periudhë provuese tremujore dhe me mundësi vazhdimi Agjensioni Kosovar i Kundërkorrupsionit ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave. Politika e punësimit të drejtë të gjitha komuniteteve të Kosovës, do të zbatohet në strukturën e stafit të Agjencionit.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistimit.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Formulari për konkurrim mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovarë Kundërkorrupsionit në Prishtinë (rruga "Bajram Kelmendi" nr. 31). Formulari zyrtar i konkurimit duhet të dorëzohet së bashku me letër motivimin dëshminë për kualifikimin shkollor, specializimin, kurset e ndjekura, përvoja e punës dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuara me të dhënat e kërkuara, si dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, do të konsiderohet i pavlefshëm.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikuar në shtypin ditor.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Mirëpresim aplikimet e femrave dhe meshkujve nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Kërkesa mund të dozet në recepcionin e ndërtesës së Agjencionit Kosovarë Kundërkorrupsionit në Prishtinë (rruga "Bajram Kelmendi" nr. 31) ose me postë, si dhe në Zyrën e Personelit nr .09 kati i dytë. Për informata shtesë mundë të telefononi në telefonin: 038 248 563 lok 118